

vetzgjedhur, sido që të jetë, është një prej pjesëzave të veshjes me të cilën gratë pajtohen duke qenë të vetëdijshme për bagazhin simbolik që ka.” (136) E kjo është që Jashari merr mbi vete kontradiktën që vjen me mbulesën dhe jo vullnetin e lirë të supozuar që Cook pretendon që gratë e kanë në raport me këtë “pjesëz të veshjes”. Duke e konfrontuar mbulesën si imazh të gruas së ashtuquajtur “Lindore” me imazhin e gruas “Perëndimore,” e cila këmbë zbuluar e takelartë ngërthen në vete po të njëjtën kontradiktë: robërimin dhe çlirimin, Jashari kontibuon në zhvillimin e këtij diskutimi, ajo e kritikon obsesionin që të dyja kulturat (patriarkale) e kanë me trupin e gruas: njëra e mbulon, e tjetra e zbulon, por asnjëri akt nuk çliron.

Të qenit e ulur në konfiguracione kulturore të ngarkuara me vija të qarta politike diskursive, Jashari me ofrimin e hapësirës së trupit të saj në vazhdimësi shtresëzon hapësirën personale me vija të tjera ndarëse, mirëpo me këtë performancë ajo gjeneron mundësinë për diskurse të reja dhe dije mbi të.

Writing Piece është e dyta me radhë në ciklin tri-pjesësh të punëve që e eksplorojnë të njëjtin koncept: *Burgeisha*, *Writing Piece*, *BarBurka*. Këto performanca përfshijnë praktikën e të qëndruarit ulur, dhe çdo herë Jashari e vë në dispozicion trupin dhe e shndërron atë në hapësirë kërkimore.



Kjo punë është performuar në Stacion-Qendra për Art Bashkëkohor kuruar nga Albert Heta (Prishtinë, Kosovë 2013), Beursschouwburg (Bruksel, Belgjikë 2014), në festivalin Mikser kuruar nga Ana Dragic (Beograd, Serbi 2014), në Meta-lurgjik e kuruar nga Ema Andrea (Elbasan, Shqipëri 2014) Celeste Prize, Asab One Gallery ku drejtor kuratorja ka qenë Elena Sorokina (Milano, Itali 2014), si dhe rishtazi në Speedy Grandma Gallery (Bankok, Tailandë 2015).

Literatura e cituar:

Butler, Judith. *Gender Trouble Feminism and the Subversion of Identity*. Routledge ed. New York, London: Routledge, 1990. Print.

Cooke, Miriam. *Women Claim Islam: Creating Islamic Feminism through Literature*. New York: Routledge, 2001. Print.

Grosz, Elizabeth. *Volatile Bodies Toward A Corporeal Feminism*. Bloomington, Indianapolis: Indiana University Press. 1994. Print.

Ky shkrim po ashtu ka për bazë intervistën me Shelbatra Jasharin të realizuar në qershor, 2014.

Shelbatra Jashari asht artiste konceptuale multi-mediale, aktore, dhe vallëtare performuese që punon me përzierjen e disa medimeve, si film, lëvizje, za, hapësinë dhe tekst. Vepra e saj hulumton elementet skulpturore të trupit njerëzor, gjendjen njerëzore dhe përfaqësimin e këtyre në sisteme të ndryshme politike dhe intelektuale. Humori, të qenit lozonjare, lojnat dhe e qeshmja janë elemente të randësishme me të cilat ajo eksperimenton. Ajo ka magjistru në Hogeschool Sint Lukas Brussels në departamentin e arteve audio-vizuele. Gjatë studimeve

të saja ajo ka hulumtu traditën filmike të pavarun dhe rranjët e saja historike në traditën filmike të njohun si arti iluzionist. Preokupimet e saja kryesore në atë hulumtim ishin reprezentimet vizuele të trupit njerëzor dhe politikat e strategjitë që janë përdorë për këtë në një nivel global brenda kapitalizmit/komunizmit/orientalizmit. Puna e saj për shkollë (filmat eksperimentalë) janë shfaqë ndërkombëtarisht në festivale të ndryshme ndërkombëtare të filmit siç janë IFFR, EIFF, etj. dhe janë shpërbly në festivalin ndërkombëtar të filmit Courtisane në Gent në 2004 dhe 2007.



PROCESI I TË SHKRUARIT I SHELBATRA JASHARIT

Erëmirë Krasniqi

Writing Piece është një performancë nga Shelbatra Jashari, me të cilën gjestikulon në drejtim të një mori pyetjesh dhe kërkon artikulum më të hollë të çështjeve si; a është trupi apo mendja që shënojnë gruan në shoqëri, apo të dyja; sa janë ato karikime patriarkale; çfarë do të thotë njëra apo tjetra; çfarë reprodukojmë përmes trupit tonë nëse atë nuk e shqyrtojmë, por e kuptojmë si proces që tashmë është i shkruar dhe së fundmi, prej kujt shkruhet gruaja nga “Lindja” dhe ajo nga “Perëndimi”.

Në traditën filozofike perëndimore për një kohë të gjatë mendja dhe trupi janë trajtuar si të ndara në raport me dijen, ku trupi është konsideru si tejet pasiv në gjenerimin e kësaj të fundit. Kjo ndarje mendje/trup, siç duket është përkthyer edhe në rrafshin shoqëror duke e aplikuar veten në thellimin e ndarjes grua/burrë.

Sipas Elizabeth Grosz, “Kontrasti mashkull/femër është i lidhur ngushtë me kontrastin mendje/trup. Zakonisht, feminiteti është i reprezentuar (drejtpërdrejtë ose tërthorazi) me njërën nga palët e këtij kontrasti dikotomik,” ajo vazhdon tutje, “Kodimi i feminitetit si trupëror, në fakt i lë burrat që lirshëm t’a jetojnë, çfarë ata (rrejtshëm) besojnë, një rend puro konceptual.” (14)

Në *Writing Piece* Shellbatra Jasharit e vë vetën në dispozicion gjegjësisht trupin saj si hapësirë komunikimi dhe gjenerimi të dijes. Në këtë performancë ajo qëndron e ulur, ndonëse vet pasive, ajo e vë në lëvizje publikun, i cili vihet në funksion të per-

formancës. Nga ta kërkohej të shkruajnë në gjymtyrët e Jasharit. Kjo punë është proces i të shkruarit të një veteje dhe të një identiteti gjinor, të cilin paradoksalisht të gjithë supozojmë që e kemi veç më.

Në këtë performancë, Jashari ia del që në një trup t’i ngërthejë dy reprezentime konvencionale të gruas, që mund të identifiko-hen gjeneralisht me ato nga Lindja/Orienti, Perëndimi/Oksidenti, në këtë mënyrë duke e hartuar trupin e saj me gjithë vijat ndarëse që vijnë me këtë gjeografi perandorake. Sidoqoftë, asnjëri reprezentim nuk e përçon kuptimin e asaj se çfarë është subjekti grua, që të dyja duken skicime të zbehta patriarkale. Kjo punë artistike është e strukturuar rreth faktit që gjinia është dialog i hapur dhe që këto skicime është e mundshme të braktisen.

Me kokë të mbuluar dhe me këmbë të zbuluara, të veshura me këpuca takelartë, e ulur, ajo fton publikun që përmes saj ta shkruajnë vetën dhe gjininë, me këtë gjest ajo e fillon procesin e shkrimit i cili siç duket është gjithnjë proces i rishkrimit. Trupi kurrë nuk gjindet në gjendje të pashkruar. Në këtë mënyrë, Jashari na rikujton që trupi shkruhet në vazhdimësi dhe këtë e bën duke instrumentalizuar me vullnetin e lirë të cilin supozohet se njeriu e ka në këtë proces të vetbërjes.

Judith Butler në dialog me Luce Irigaray në librin e saj *Gender Trouble* e shqyrton statusin e trupit të gruas në raport me dijen, një ndër argumentet kyçe të këtij diskutimi vijon kështu, gratë reprezentojnë fizionominë e cila nuk mund të sintetizohet si mendim, pasi që “trupi i gruas ekziston brenda gjuhës *fallocentrike*” (14). Mirëpo, meqenëse gruaja është e shënuar me kastrim, kjo gjuhë e përjashton dhe dështon që përmes saj të gjeneroj dije. Sidoqoftë, me këtë Butler propozon se një situatë e tillë mund të strategjizohet ndryshe përbrenda politikave identitare. Nëse gruaja është e përjashtuar nga procesi i prodhimit të dijes, dhe është

jashtë procesit të shënjimit, ajo është e përjashtuar vetëm në njërën nga mënyrat e mundshme dhe kjo në parim nuk e përjashton, por e çliron atë nga sistemi heteronormativ i dijes.

Jashari përmes performancës kërkon të komunikojë në këtë gjuhë që ta bëjë më të dukshme inxhinierimin e identitetit heteronormativ që vendosë burrin si subjektin dominant në prodhimin e dijes. Të performuarit e të shkruarit të trupit dhe të gjinisë nga Jashari, ndoshta ndonjëherë duket se bëhet në mënyrë tejet demonstrative e madje edhe bukvalë, por kjo praktikë vetëm sa e heq petkun dhe zbulon procesin e fabrikimit dhe fikcionin rreth tyre.

Për më tepër, trupi nuk është genie e ngurtë, trupat mbarohen, modifikohen, rikonfigurohen, dhe si të tillë janë shoqërisht të varur, këtë Jashari e konfirmon me vet performancën, ku ajo nuk pretendon të ketë pushtet mbi të, andaj edhe e zhvendosë këtë supozim nga vetja tek tjetri, me këtë distancim ajo e transformon trupin e saj në një hapësirë ku dija kolektive e legjitimon dhe e ushtron pushtetin. Si rezultat, trupi i saj përdoret që të gjenerojë dije mbi mënyrat se si shoqërisht shkruhen trupat, e si pasojë edhe gjinia.

Writing Piece është fëmiju konceptual i filmit të shkurtër *Kismet* të Jasharit. Ky film sipas saj, është bazuar në ndodhitë të cilat tashmë janë në harresë, dhe të cilat madje përjetohen si të paqena. Simultanisht, kjo punë është inspiruar nga shumë artistë tjerë të cilët punojnë në të njejtat çështje. Participimi në të njejtin diskurs dhe të qenit në konverzacion ideor me artistët si; Shirin Neshat, Princess Hijab, Theo Van Gogh, sipas Jasharit, kjo e ka ndihmuar atë që të kuptuarit mbi këto çështje të evluojë.

Çfarë e ka informu aspektin performativ të *Writing Piece* është puna e Joseph Kosuth *Chair* (1965). Jasharin e ka intrigu

një rrethanë shumë e zakonshme, të qëndrosh e ulur. ‘Natyra’ e punës sot e detyron njeriun që kohën kualitative ta kalojë pasivisht i ulur, praktikë kjo që shkon kundër ‘natyrës’ aktive njerëzore. Ka diçka kontradiktore me faktin që aktiviteti jonë njerëzor, puna, artikulimi i të qenit në botë realizohet duke qëndruar ulur.

Writing Piece njikohësisht eksperimenton me aftësinë njerëzore, atë të përballimit, përgjatë këtij qëndrimi ulur me kokë të mbuluar, ajo nuk merr frymë mjaftueshëm, nuk e sheh dritën por as të tjerët, i mundëson publikut, që në vetvete reprezenton publikun, të ketë privatësi. Përderisa ajo vet, përbrenda konditave të kësaj pune që replikon rendin shoqëror dhe statusin e gruas në të, i mohohet çfarëdo që potencialisht do të mund ta ketë kuptimin e privates. Me këtë Jashari na thotë që trupi i gruas është ai në të cilin gjithnjë ndërhyhet nga jashtë.

Për më tepër, kultura e sotme industriale qoftë “Perëndimore” apo ndonjë margjinë tjetër gjeografike që mbanë lartë këtë vlerë, nuk ka lënë asnjë aspekt të trupit të gruas pa ndërhyrë dhe pa e ndryshuar. Me të trajtuar atë si mall çdo karakteristikë e fytyrës së gruas, çdo seksion i trupit të saj, i është nënshtruar shqyrtimit patriarkal. Kjo ndërhyrje ka qenë dhe është në funksion të bërjes së diferencimit grua/burrë. Me modifikimin e gruas, gruaja gjithnjë është prodhuar dhe prodhohet si e kundërt nga burri, dhe në shërbim të mirëmbajtjes së definicionit burrë, si pasojë, ajo nuk prodhohet si subjekt në vete dhe për veten.

Për Jasharin, kjo punë performative ka qenë poashtu edhe një nga mënyrat për t’i kuptuar motivet që qëndrojnë në prapavi të realitetit material të mbulesës së kokës. Me këtë punë, Jashari duket se vjen në të njejtën pikë me Cook, por jo plotësisht, sipas të cilës, “... imazhi i mbulesës është i ngarkuar me kontradikta të shumta. Robëron dhe çliron. Nëse mbulesa është e imponuar apo e